



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 23.10.2020

Dokument parlamentar
(Komision për dhënie mendimi)

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ANGAZHIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, DHE ALEANCËS GAVI, PËR PJESËMARRJEN NË STRUKTURËN GLOBALE TË QASJES NË VAKSINAT COVID-19 (COVAX FACILITY)”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 23.10.2020, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (Covax Facility)”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Milva Ekonomi.

Për të prezantuar projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent Z. Albert Nikolla, zv. ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj. Geraldina Prodani, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Dr. Albana Dico, Drejtor i Institutit të Shëndetit Publik dhe Z. Gentian Opre, Drejtor i Analizës dhe Programeve Buxhetore pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës.

Gjithashtu projektligji është në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” si dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, vlera, afati i marrëveshjes dhe përmbajtja e projektligjit.

Qëllimi i projektligjit:

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX Facility).

Kjo marrëveshje do të mundësojë krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe administrativ për sigurimin/blerjen e vaksinës kundër COVID-19, me qëllim mbrojtjen e popullsisë nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

Pas vlerësimit të Komitetit të Ekspertëve për Imunizimin dhe pas negociatave është është dakortësuar që dozat totale të vaksinës që mund të ofrohet nga COVAX Facility do të jenë 1,140,000, me dy doza vaksine, sasi kjo që vlerësohet e mjaftueshme për të vaksinuar popullsinë, referuar sasisë për vaksinimin ndaj gripit sezonal 2020-2021.

Vaksina e cila do të prokurohet duhet të ketë kualifikimin parapak të OBSH-së ose që mbi baza të jashtëzakonshme, minimalisht, zotëron licencën/autorizimin e vendosur nga një SRA.

Vlera totale e kësaj marrëveshjeje është 3 990 000 (tre milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) dollarë amerikanë.

Marrëveshja fillon në datën e përcaktuar në të dhe, do të përfundojë pas 3 vitesh nga fillimi i efekteve të saj, nëse nuk ka vaksinë të miratuar ose datën në të cilën Gavi dhe Shteti Shqiptar bien dakord reciprokisht me shkrim për të përfunduar këtë Marrëveshje. Gjithashtu marrëveshja përmabn edhe klauzola specifike lidhur me rastet e përfundimit të marrëveshjes si pasojë e shkeljes/mos respektimit nga palët të dispozitave të marrëveshjes.

Marrëveshja është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.734, datë 16.9.2020, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX FACILITY).

Përmbajtja:

Projektligji përbëhet nga 2 nene gjithsej.

- Neni 1 parashikon ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX Facility).
- Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit.

IV. Efektet Financiare

Projektligji shoqërohet me efekte financiare. Vlera totale e kësaj marrëveshjeje është 3 990 000 (tre milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) dollarë amerikanë, e cila përbëhet nga:

- Pagesa e shumës paraprake të pakthyeshme dhe të pakushtëzuarv në vlerën 3 534 000) USD.
- Shuma e garancisë së ndarjes së rrezikut (në vlerën 456 000 USD).

Kjo shumë do të paguhet nga buxheti i alokuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

V. Vlerësimi i nivelit të përafrimit

Projektligji nuk synon të përafroje ndonjë acquis.

VI. Shqyrtimi i projektligjit në komision:

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij u shpreh se synimi i kësaj iniciative dhe nevoja për ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX Facility) është sigurimi/blerja e vaksinës kundër COVID-19, me qëllim mbrojtjen e popullsisë nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

GAVI dhe COVAX Facility

Aleanca GAVI është një partneritet global, i cili ka në përbërje të tij organizata të specializuara të Kombeve të Bashkuara, si OBSH, UNICEF, Banka Botërore si dhe partnerë të tjerë që merren me kërkimin dhe zhvillimin e produkteve mjekësore dhe programeve të shëndetit publik. Kjo aleancë luan një rol kritik në forcimin e kujdesit shëndetësor parësor (PHC), duke na sjellë më pranë zhvillimit të qëndrueshëm me qëllim mbulimin universal të shëndetit duke siguruar që askush të mos mbetet prapa. Për Shqipërinë, anëtarësimi në këtë Aleancë dhe prokurimi i vaksinës nëpërmjet këtij

mekanizmi ofron një vaksinë të sigurt dhe të certifikuar, gjithashtu, është më fleksibël dhe nuk ka kosto shtesë për shtetin Shqiptar (kostoja finale është e njëjtë).

Aleanca GAVI menaxhon COVAX Facility, një mekanizëm i krijuar për të garantuar akses të shpejtë, të drejtë dhe të barabartë në vaksinat COVID-19 për çdo vend në botë, qoftë ky i pasur apo i varfër. Aleanca GACI është një strukturë globale, me anë të së cilës vendet kanë mundësinë të përfitojnë nga një portofol i kandidatëve për vaksina, duke përdorur një sërë platformash teknologjike, të prodhuara nga më shumë prodhues në të gjithë botën, me një treg më të madh për të garantuar sigurinë e kërkesës, me një fushëveprim më të madh sesa qeveritë ose grupet rajonale mund të mbështesin vetë, duke i dhënë popullsisë së tyre qasje të hershme në vaksina të sigurta dhe efikase.

COVAX Facility është krijuar si një mekanizëm global për të nxitur zhvillimin e shpejtë të vaksinave kandidate ndaj COVID-it, prodhimin në masë të gjerë të vaksinave të certifikuara dhe shpërndarjen e shpejtë e të barabartë për të gjitha vendet. COVAX është një nga katër shtyllat e Acces to Covid-19 Tools (ACT), që u lançua në prill 2020 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), Komisioni Evropian dhe Franca, për t'iu përgjigjur sfidave të krijuara nga pandemia e shkaktuar nga COVID-19, si bashkim i qeverive, organizatave shëndetësore (të nivelit global), prodhuesve, shkencëtarëve, sektorit privat, shoqërisë civile, me synimin për të siguruar një qasje inovative dhe të barabartë në diagnostikimet, trajtimet dhe vaksinat COVID-19.

COVAX Facility monitoron vazhdimisht situatën e zhvillimit të vaksinave kundër COVID-19, për të identifikuar kandidatët më të përshtatshëm të vaksinave (ndërmjet prodhuesve të saj), bazuar në kompatibilitetin shkencor dhe aftësinë për t'u prodhuar në masë dhe punon me prodhuesit për t'i stimuluar ata që të zgjerojnë kapacitetin e tyre të prodhimit para se vaksinat të marrin miratimin rregullator.

Qëllimet e këtij angazhimi janë gjithashtu:

- të zhvillojë një portofol të madh dhe të larmishëm të menaxhuar në mënyrë aktive të kandidatëve për vaksina COVID-19 për të maksimizuar probabilitetin e suksesit të disa kandidatëve, në mënyrë që vaksinat më të mira të vihen në dispozicion përfundimisht dhe furnizimi të jetë i mjaftueshëm për popullatat me përparësi më të lartë globalisht për të gjithë Pjesëmarrësit dhe Ekonomitë e Kualifikuara të COVAX ATA;
- të dorëzojë të paktën 2 miliardë doza të Vaksinave të Miratuara deri në fund të vitit 2021;
- të garantojë aksesin në Vaksinat e Miratuara për çdo ekonomi pjesëmarrëse; dhe
- të përfundojë fazën akute të pandemisë deri në fund të vitit 2021.

Duhet të theksojmë se aktualisht nuk kemi ende një vaksinë të certifikuar.

Arsyet e nevojës për pjesëmarrje në këtë strukturë dhe ratifikimin e kësaj marrëveshje

Miratimi dhe ratifikimi i kësaj marrëveshjeje bëhet një domosdoshmëri, duke vlerësuar nevojën absolute për sigurimin e vaksinës së covid -19. Duhet të sqarohet se zakonisht, prodhuesit hezitojnë të rrezikojnë të bëjnë investime të konsiderueshme për të prodhuar vaksina në sasi të mëdha derisa të marrin miratimin për një vaksinë. Në kontekstin e pandemisë aktuale, kjo do të çonte në mënyrë të pashmangshme në vonesa të konsiderueshme dhe fillimisht mungesë në tregun e vaksinave (pasi të arrihej licencimi). Pikërisht për të shmangur këtë mungesë apo pamundësi për sigurimin në dozë të mjaftueshme për vendet të vaksinës, COVAX Facility po punon me prodhuesit për të siguruar investime dhe stimuj për të siguruar që prodhuesit të jenë të gatshëm për të prodhuar dozat që duhen. Faciliteti, gjithashtu, do të përdorë fuqinë blerëse kolektive që vjen nga pjesëmarrja e kaq shumë vendeve në mënyrë që të negociojnë çmime mjaft konkurruese nga prodhuesit që më pas u kalohen pjesëmarrësve.

Sasia e vaksinës dhe mënyra e përlllogaritjes së nevojave.

Për të mundësuar një vlerësim të specializuar lidhur me këtë iniciativë dhe për të përcaktuar target grupet përfituese apo përqindjen e popullsisë që do të vaksinohet, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u ngrit Komiteti Kombëtar i Imunizimit.

Ky komitetet ka mbështetur pjesëmarrjen e Shqipërisë në iniciativën e Facilitetit COVAX (COVAX Facility), e cila ofron një mundësi të mirë për të siguruar një vaksinë të sigurt dhe efikase ndaj COVID-19. Vendimet e tij janë bazuar në sugjerimet dhe vendimet e marra nga Komiteti I Ekspertëve për Imunizimin.

Komiteti ka mundësuar edhe përlllogaritjen e sasisë së vaksinës që do të nevojitet duke iu referuar sasisë për vaksinimin ndaj gripit sezonal 2020-2021.

Pas negociatave është dakortësuar që dozat totale të vaksinës që mund të ofrohet nga COVAX Facility sipas kësaj marrëveshjeje do të jenë 1,140,000, me dy doza vaksine, sasi kjo që vlerësohet e mjaftueshme për të vaksinuar 20% të popullsisë.

Vaksina e cila do të prokurohet duhet të ketë kualifikimin parapak të OBSH-së ose që mbi baza të jashtëzakonshme, minimalisht, zotëron licencën/autorizimin e vendosur nga një SRA.

Vlera e marrëveshjes/pagesat

Vlera totale e kësaj marrëveshjeje është 3 990 000 (tre milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) dollarë amerikanë, e cila përbëhet nga:

- Pagesa e shumës paraprake të pakthyeshme dhe të pakushtëzuarv në vlerën 3 534 000) USD.
- Shuma e garancisë së ndarjes së rrezikut (në vlerën 456 000 USD).

Pas kryerjes së pagesës GAVI do të marrë përsipër, të njoftojë në vijimësi për çdo mundësi për të blerë vaksinat e miratuara nga një prodhues i përcaktuar, duke përcaktuar kushtet kryesore të prokurimit dhe të shpërndarjes së vaksinave të miratuara nga prodhuesi përkatës i përcaktuar.

Marrëveshja krijon mundësi gjithashtu që në rast se Shqipëria në cilësinë e vendit pjesëmarrës nuk dëshiron të marrë pjesë në një mundësi blerjeje, duke vendosur si kushtëzim njoftimin për këtë qëllim paraprakisht të GAVI-it.

Marrëveshja ka parashikuar gjithashtu edhe rastet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të mundshme, përmes arbitrazhit I cili do të kryhet në përputhje me rregullat në fuqi të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare të Tregtisë.

Marrëveshja parashikon edhe të drejtën e palës shqiptare për të përdorur edhe negociimin si mjet diplomatik për të zgjidhur mosmarrëveshjet e lindura.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shpjeguan dhe dhanë informacion të hollësishëm përpara komisionit lidhur me nevojën për bashkëpunimin me GAVI-n, mundësitë që ofron ky bashkëpunim, detaje lidhur me procesin e negociimit të marrëveshjes, kush do të jetë target grupi i synuar për të përfituar nga vaksina.

Anëtarët e komisionit, e mirëpritën njëzëri miratimin e këtij projektligji si dhe u interesuan lidhur me kapacitetet e ministrisë për hartimin e një plani konkret shpërndarjeje të vaksinës si dhe infrastrukturës së nevojshme për këtë qëllim.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shpjeguan se aktualisht janë marrë të gjitha masat dhe se kjo ministri zotëron të gjithë infrastrukturën e nevojshme për administrimin e vaksinës përmes të njëjtave strukturave që administrojnë edhe vaksinat e gripit sezonal. Kjo vaksinë do të shërbejë për target grupet të cilat janë edhe më të rrezikuarat, kryesisht punonjësit që përballen me virusin në frontin e parë si dhe shtresat e tjera të popullatës që janë më të ndjeshme dhe me vulnerabël ndaj virusit.

VII. Përfundime

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, konstatoi se për sa i përket anës formale të projektligjit, shtojcat që i bashkangjiten marrëveshjes, nuk janë të plota dhe për këtë arsye i sugjerojmë komisionit përgjegjës, kërkimin tek Këshilli i Ministrave të plotësimit të tyre përpara shqyrtimit të projektligjit në seancën plenare.

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi si dhe duke vlerësuar se miratimi i këtij projektligji do të mundësojë sigurimin/blerjen e vaksinës kundër COVID-19, me qëllim mbrojtjen e popullsisë nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

KRYETAR

Milva EKONOMI